



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2431, datë 13.03.2014**

**Për**

**“Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës 13.03.2014, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare**

**B A Z A L I G J O R E:**

1. Neni 7, gërma b) e nenit 8, neni 45, nenet 53-59, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (*Ligji nr.9918, i ndryshuar*);

2. Vendimet e KD Nr. 2118-2122, datë 4.07.2012, për miratimin e dokumentit final të analizës së tregut dhe përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat përkatëse rreguluese.
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP,
4. Vendimi i KD nr.2412, datë 16.01.2014 për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””.

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Versioni përfundimtar i dokumnetit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”;
- Dokumentin “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”
- Komentet e palëve të interesuara si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## **V Ë R E N:**

1. AKEP me Vendimin nr..2412, datë 16.01.2014 miratoi nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”. Periudha e këshillimit publik u zhvillua për një muaj më 16.01.2014-16.02.2014.
2. Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komentet palët e intersuara të mëposhtëme:
  - a. AMC me shkresën Nr.814 Prot., datë 12.02.2014;
  - b. Albtelecom me shkresën Nr.1109 Prot, datë 14.02.2014;
  - c. Vodafone Albania me shkresën ref. LRD/0038/OX, datë 14.02.2014;
  - d. Plus Communication me shkresën Prot.Nr.195, datë 15.02.2014;
3. Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr.1076, datë 6.12.2013, ka përgatitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Versionin përfundimtar të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”.
  - Dokumentin “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”, i cili përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet.
4. Grupi i Punës në përgatitjen e dokumentacionit të përgatitur ka marrë në konsideratë:
- Rekomandimin e Komisionit Evropian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC)
  - Të dhënat e Komisionit Evropian të publikuara për Axhendën Dixhitale të BE
  - Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifën e terminimit në rrjetet celulare
  - Të dhëna të publikuara nga Cullen International në lidhje me aplikimin e LRIC të pastër
  - Kushtet aktuale të tregut celular në Shqipëri
  - komentet e palëve të interesuara të depozituara në përfundim të këshillimit publik.
5. AKEP, vlerëson se dokumenti “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, përbën një dokument të rëndësishëm rregullator për realizimin e objektivave të AKEP për nxitjen e konkurrencës në tregun celular dhe maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve fundorë nga shërbimet celulare, dhe është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, duke marrë në konsideratë rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC-ut si dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar.
6. Dokumenti “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*” si dhe vendimet individuale për secilin sipërmarrës ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve celulare që do merren në bazë të këtij dokumenti, për rishikimin nivelit të tarifave të shërbimit me shumicë të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e secilit operator celular me FNT, për orientimin në kosto LRIC të pastër, sipas rekomandimeve të KE, janë të rëndësishme dhe me interes për të gjithë tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues, duke marrë në konsideratë rëndësinë e publikimit të dokumentit të cituar, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë dokumentat:

- a. “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, sipas dokumentit bashkëlidhur në Aneks 1;

- b. “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara” për dokumentin e nxjerrë në këshillim public, sipas dokumnetit bashkangjitur në Aneks 2;
2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuara në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

**Aneks 1:**

# **Rishikimi**

## **i tarifave të terminimit të thirrjeve**

### **në rrjetet celulare**

### **Dokumenti Përfundimtar**

**Miratur me VKD nr 2431 datë 13.03.2014**

**(publikuar si dokument me vehte)**

Aneks 2:

**Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara  
për dokumentin e nxjerrë në këshillim public: Rishikimi i tarifave të  
terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”**

**Miratuar me VKD nr 2431 datë 13.03.2014  
(publikuar si dokument me vehte)**



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Rishikimi  
i tarifave të terminimit të thirrjeve  
në rrjetet celulare**

**Dokumenti Përfundimtar**

Miratuar me VKD nr.2431, datë 13.03.2014

## Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje .....	3
2.	Ecuria e nivelit të tarifave të terminimit dhe tregut celular në Shqipëri .....	6
3.	Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe tarifatat mesatare të terminimit në BE dhe rajon.....	8
3.1.	Rekomandimi i KE 2009/396/EC, datë 7 Maj 2009 .....	8
3.2.	Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe rajonit .....	9
3.2.1.	Tarifatat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE .....	9
3.2.2.	Tarifatat mesatare të terminimit celular sipas BEREC .....	10
3.2.3.	Tarifata mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër.....	11
3.2.4.	Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark) .....	14
4.	Rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri ...	15
4.1	Alternativat për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare .....	15
4.2.	Rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare .....	16
5.	Efektet e pritshme .....	21
Aneks 1:	Lista e Shkurtimeve të Shteteve .....	26

## Lista e Tabelave dhe Figurave

TABELA 1: REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT NË RRJETET CELULARE 2010-2015 (LEKË/MINUTE) .....	7
TABELA 2: TARIFAT E TERMINIMIT CELULARE DHE APLIKIMI I LRIC I PASTËR 2013-2015.....	12
TABELA 3: VLERAT MESATARE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR (BENCHMARK) .....	14
TABELA 4: VLERAT MAKSIMALE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR NË SHQIPËRI 2014-2016.....	18
TABELA 5: ASIMETRIA NË PËRQINDJE E TARIFAVE TË TERMINIMIT .....	18
TABELA 6: ASIMETRIA (DIFERENCA) NË VLERË ABSOLUTE E TARIFAVE TË TERMINIMIT (LEK/MINUTË).....	18
TABELA 7: NDRYSHIMET NË PËRQINDJE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT NË SHQIPËRI (1.04.2014-1.01.2016).....	22
FIGURA 1: TARIFAT MESATARE TË TERMINIMIT NË VENDET E BE (JANAR 2012 DHE JANAR 2013).....	10
FIGURA 2: TARIFAT MESATARE TË TERMINIMIT SIPAS VENDEVE NË KORRIK 2013 .....	11
FIGURA 3: TARIFAT MESATARE TË TERMINIMIT NË VENDET E BE DHE RAJONIT DHE SHQIPËRI (2012-2016) .....	21



# 1. Hyrje

---

AKEP në analizën e tregut celular të miratuar më 4.07.2012, në Seksionin III.3.IV, në trajtimin e masave rregulluese për FNT të operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre, ka përfshirë disa paragrafë në lidhje me Rekomandimin e Komisionit Evropian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC),<sup>1</sup> i cili rekomandon midis të tjerave rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare sipas metodës BU-LRIC të pastër. Në përfundim të diskutimit mbi rekomandimin e cituar, AKEP gjykoi të vazhdojë me implementimin e fazave të reduktimit të pershkallezuar (glide path) të përcaktuara në Shkurt 2011, që për tre operatorët më të mëdhenj përfundoi me aplikimin e fazës së fundit të reduktimit në Shtator 2013, duke barazuar tarifat e tre operatorëve me rezultatin e modelit BU-LRAIC. Njëkohësisht, AKEP në pjesën e referuar të Analizës u shpreh se:

*Per periudhen pas 2013 AKEP gjykon se aplikimi i modelit BULRAIC i paster dhe rekomandimit te KE do te ishte menyra me e mire per rregullimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare. Per te realizuar kete AKEP, do te ndertoje nje model te ri te paster BULRAIC ose do te perdore nivelin benchmark te vendeve qe e kane ndertuar keto modele per percaktimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare (sipas rekomandimit te KE), si dhe do te ndjeke te gjitha procedurat e konsultimit publik dhe njoftimit te paleve te interesuara per keto procedura.*

AKEP me Urdhërin nr.1076, datë 6.12.2013, ka ngritur një Grup Pune për “Hartimin e dokumentit rregullator për rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare”. Në vijim të këtij Urdhëri, AKEP njoftoi operatorët për fillimin e procedurës për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare dhe Grupi i Punës zhvilloi një takim me operatorët celularë më datë 13.12.2013. Në takim operatorët dhanë disa opinione paraprake për çështje të tilla si:

- Efekti i asimetrisë së tarifave në pagesat midis operatorëve
- Asimetri v simetri
- Transparencën e procesit dhe metodës së përcaktimit të tarifave

Gjatë vitit 2013, sipërmarresit Plus Communications dhe Albtelecom nëpërmjet disa shkresave kanë kërkuar ndërhyrje të AKEP në tregun e telefonisë së levizshme për të adresuar problemet

---

<sup>1</sup> COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC)

me konkurrencën në këtë treg. Shkresat e Plus përqëndrohen në kërkesa për rishikimin e modelit BULRAIC/asimetrise së tarifave të terminimit të thirrjeve dhe mesazheve SMS, duke dhënë edhe propozime për nivelin e tarifave të terminimit për t'u aplikuar midis operatorëve celularë. Altelecom ka dërguar shkresa për adresimin e disa problematikave në konkurrencën në tregun celular, duke propozuar aplikimin e tarifave sipas modelit të kostove BULRAIC të pastër për AMC dhe Vodafone, nivel të ri asimetrie për EM dhe Plus ndaj AMC dhe Vodafone, vendosjen e detyrimeve për tarifatat me pakicë të operatorëve dominantë etj. Të dy operatorët ngrenë problemin e pamundësisë për të konkurruar me dy operatorët e mëdhenj dhe diferencat e mëdha të tarifave on-net/off-net dhe/ose të tarifave shumë të ulëta on-net.

Plus Communications është drejtuar me ankesë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në Nëntor 2012, dhe AK pas procedurës së hetimit paraprak, ka marrë Vendimin Nr.275, datë 25.03.2013 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë", vendim i publikuar edhe në faqen e internetit të AK.

AKEP ka bashkëpunuar me AK gjatë gjithë kësaj kohe, nëpërmjet dërgimit të informacioneve të kërkuara nga AK, zhvillimit të takimeve në nivel ekspertësh për procedurat e nisura nga AK si dhe dërgimit të opinionit të ekspertëve për raportin e hartuar nga grupi i punës së AK për hetimin e thelluar.

Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën nr.38, datë 25.01.2014 ka dërguar në AKEP Vendimin nr.303, datë 16.01.2014, "Per Mbylljen e Hetimit te Thelluar ne tregun e telefonise celulare me pakice ndaj ndermarrjes Vodafone Albania sh.a dhe rekomandime per AKEP", vendim i publikuar edhe në faqen e internetit të AK. Vendimi nr.303, datë 16.01.2014 është marrë në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar të nisur nga AK me Vendimin nr. 275, datë 25,03.2013, "Per hapjen e procedures se hetimit te thelluar ndaj ndermarrjes Vodafone Albania SHA ne tregun e telefonise celulare me pakice". Nëpërmjet vendimit AK ka përcaktuar se Vodafone Albania ka pasur pozitë dominuese në periudhën 2011-2012 por nuk ka abuzuar me këtë pozitë. AK ka vendosur mbylljen e hetimit ë të thelluar duke dhënë disa rekomandime për AKEP.

### **Këshillimi Publik**

AKEP me Vendimin nr.2412, datë 16.01.2014 miratoi publikimin e dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare” për këshillim publik, nëpërmjet të cilit propozoi rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë duke u bazuar në përvojat ndërkombetare për aplikimin e BULRAIC të pastër, sipas Rekomandimit të KE (2009/396/EC) të datës 7 Maj 2009, të referuar edhe në Analizën 2012. Këshillimi publik u krye për një periudhë 1-mujore në përputhje me nenin 110 të Ligjit 9918. Në përfundim të periudhës së këshillimit publik në AKEP u depozituan komente nga katër operatorët celularë. AKEP pasi ka shqyrtuar komentet e palëve të interesuara ka përgatitur këtë version final të dokumentit për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet celulare. Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP për komentet e dhëna janë përmbledhur në dokumentin “Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP”.

Nëpërmjet këtij dokumenti AKEP ka adresuar edhe problematikën e referuar nga operatorët si dhe komentet paraprake të shprehura nga operatorët në takimin e datës 13.12.2013, si dhe ka reflektuar ndryshime në vijim të komenteve të sjella në përfundim të periudhës së këshillimit publik. Qëllimi i rishikimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është përmbushja e objektivave rregullatore për nxitjen e konkurrencës në treg dhe maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve nga shërbimet celulare.

## 2. Ecuria e nivelit të tarifave të terminimit dhe tregut celular në Shqipëri

---

Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare ka qene objekt rregullimi nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC<sup>2</sup> i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare.

AKEP me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celulare (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendim-marrjes). Vendimet 1506-1508, përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile.

Në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër. Tarifat e përcaktuara me vendimet 2118-2122, datë 4.07.2012 ishin të njëjta me Vendimet 1505-1508, duke konfirmuar reduktimin e përshkallëzuar të vendosur në Shkurt 2011, me disa ndryshime për operatorin Plus Communications.

Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të AMC, Vodafone dhe EM janë reduktuar dhe më 1.09.2013 kanë arritur nivelin e koston 4.57 lek/minutë, ndërsa për Plus është vendosur aplikimi i asimetrisë dhe do të arrijë nivelin 4.57 lek/minutë më 1.09.2015. Ecuria e tarifave të terminimit nga viti 2010 dhe vlerat e miratuara me vendimet e datës 4.07.2012 janë dhënë në tabelën e mëposhtëme.

---

<sup>2</sup> Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Koston Mesatare Inkrementale Afatgjatë)

**Tabela 1: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit në rrjetet celulare 2010-2015 (lekë/minute)**

	2010	1.03.2011	1.09.2011	1.09.2012	1.09.2013	1.09.2014	1.09.2015
<b>AMC, Vodafone</b>	10.5	8.85	7.57	6.10	4.57	4.57	4.57
<b>Albtelecom (Eagle Mobile)</b>	12.92	10.89	8.85	6.52	4.57	4.57	4.57
<b>Plus Communications</b>	18.90	18.90	18.90	12.92	8.85	6.52	4.57

**Shënim: Tarifat janë pa TVSH**

Vlerat e mësipërme janë vendosur nga AKEP në Shkurt 2011 duke iu referuar rezultateve të modelit BULRAIC të përgatitur me konsulencë ndërkombëtare dhe rekomandimit të konsulentit për reduktimin e përshkallëzuar, me ndryshimet e mëposhtëme:

- Vlerat e tarifave të terminimit në rrjetet AMC dhe Vodafone më 1.03.2011 janë vendosur 8.85 lek/ minutë në krahasim me 9.03 lek/ minutë të propozuar nga konsulenti;
- Vlerat e tarifave të terminimit për EM më 1.03.2011 dhe 1.09.2011 janë vendosur 10.89 dhe 8.85 lek/ minutë respektivisht në krahasim me 10.31 dhe 8.42 lek/ minutë të propozuar nga konsulenti;
- Vlerat e tarifave të terminimit në rrjetin Plus Communications 2010-31.08.2012 janë përcaktuar bazuar në procedimet administrative për zgjidhje mosmarrvëshje dhe vendimet e AKEP më 4.07.2012 për periudhat 1.09.2012 e në vijim.

# 3. Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe tarifrat mesatare të terminimit në BE dhe rajon

---

## 3.1. Rekomandimi i KE 2009/396/EC, datë 7 Maj 2009

Komisioni Evropian, ERG (sot BEREC) në dokumenta të ndryshme ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, kanë rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre). Komisioni Evropian në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*, ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:

- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifrat duhet të jenë simetrike;
- Vlerësimi i kostove efiente të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale me metoden BU, si metodologjia e duhur e kostove;
- Regullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;
- Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC;
- Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstrohet se hyrësit e rinj kanë dizavantazh në raport me operatorët e tjerë.

Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë, dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC).

Ky rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE dhe njëkohësisht ka filluar implementimi edhe në disa vende të rajonit. Seksioni 3.2.3 trajton aplikimin LRIC të pastër në Evropë.

## **3.2. Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe rajonit**

Për sa i përket nivelit të tarifave mestare të aplikuara në vendet e BE dhe në rajon, AKEP ka grumbulluar informacion duk iu referuar burimeve të mëposhtëme:

- Të dhënat e Komisionit European të publikuara për Axhendën Dixhitale të BE<sup>3</sup> (Financial indicators fixed and mobile telephony broadcasting and bundled services indicators);
- Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifrat e terminimit në rrjetet celulare (Janar dhe Korrik 2013).
- Të dhëna të publikuara nga Cullen International në lidhje me aplikimin e LRIC të pastër


### **3.2.1. Tarifrat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE**

Të dhënat më të fundit të publikuara nga KE në lidhje me tarifrat e terminimit në vendet e BE, përmbajnë tarifrat e aplikuara në 27 vendet anëtare të BE, duke iu referuar situatës deri më 1 Janar 2013. Këto të dhëna janë paraqitur në Figurë 1, më poshtë.

---

<sup>3</sup> <http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/download-data>

Figura 1: Tarifatat mesatare të terminimit në vendet e BE (Janar 2012 dhe Janar 2013)



Burimi: EC Digital Agenda for Europe.


Tarifa mesatare në vendet e BE në Janar 2013 ishte 2.33 eurocent/minutë, që përbën një rënie me 41% nga tarifa mesatare prej 3.95 eurocent/minutë në Janar 2012.

### 3.2.2. Tarifatat mesatare të terminimit celular sipas BEREC

BEREC (më parë ERG) kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Publikimet janë cdo gjashtë muaj dhe dy publikimet e fundit në 2013, paraqesin situatën e tarifave të terminimit në Janar 2013 dhe në Korrik 2013, në 34 vende Evropiane. Në këtë listë përfshihen 27 vendet anëtare të BE plus 7 vende të tjera Evropiane, përfshirë disa vende me status kandidat për anëtar në BE. Figura e mëposhtme paraqet tarifatat e terminimit në rrjetet celulare më 1 Korrik 2013.



Figura 2: Tarifatat mesatare të terminimit sipas vendeve në Korrik 2013



Burimi: BEREC BoR (13) 178 rev2

Sipas të dhënave të mësipërme tarifa mesatare e thjeshtë<sup>4</sup> është 2.21 Eurocent/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar<sup>5</sup> 1.46 eurocent/minutë. Tarifa mesatare e ponderuar më 1 Korrik 2013 është reduktuar me 23% në krahasim me 1 Janar 2013.

### 3.2.3. Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër

Tabela e mëposhtme paraqesin vlerat e tarifave të terminimit në 34 vendet që raporton BEREC, më 1.01.2013 dhe 1.07.2013, si dhe informacion për vendet që kanë aplikuar LRIC deri në 2013 dhe ato që kanë marrë vendime/propozuar për aplikim deri në 2015. Informacioni është marrë nga raportet e BEREC të përmendura në seksionin e mëparshëm dhe Cullen International<sup>6</sup>.

<sup>4</sup> Mesatarja e tarifave të 34 vendeve

<sup>5</sup> Mesatarja e tarifave të 34 vendeve e ponderuar me peshën e numrit të pajtimatrëve të secilit vend në raport me totalin

<sup>6</sup> Mobile termination rates – Moving towards pure LRIC? Update December 2013 and February 2014

Tabela 2: Tarifatat e terminimit celulare dhe aplikimi i LRIC i pastër 2013-2015

Vendi	Tarifat 2013		Data e aplikuar/propozuar	Vlera e aplikuar/propozuar
	1.01.2013	1.07.2013		
AT	2.0100	2.0100	1.11.2013	0.8049
BE	1.1800	1.1800	1.01.2013	1.1800
BG	2.2523	1.1760	1.07.2013	1.1760
CH	6.3409	5.8830		
CY	1.7293	1.7349		
CZ	1.6291	1.0453	1.07.2013	1.0453
DE	1.8500	1.8500		
DK	1.0725	1.0730	1.01.2013	1.0730
EE	1.4700	1.2900		
EL	1.2690	1.2690	1.01.2015	1.0990
ES	3.1739	1.0900	1.07.2013	1.0900
FI	2.8000	2.8000		
FR	0.8394	0.8000	1.01.2013	0.8000
FYROM	5.7244	5.7149	1.09.2014	1.4600
HR	2.5804	2.5580	1.01.2015	0.8260
HU	2.4925	2.3889		
IE	2.6003	1.0400	1.07.2013. Pezulluar	1.0400
IS	2.4492	2.5394		
IT	1.5206	0.9800	1.07.2013	0.9800
LT	1.8489	1.0426	N/A	0.6570
LU	8.5525	8.5525		
LV	3.7377	1.5694		
MT	2.0700	2.0700	N/A	0.4000
NL	2.4000	2.4000	1.09.2013 Pezulluar	1.0170
NO	2.0413	1.9707		
PL	2.0086	1.0214	1.07.2013	1.0214
PT	1.2700	1.2700	1.01.2013	1.2700
RO	3.0700	3.0700	2014	0.8600
RS	4.2298	4.2828		
SE	1.7395	1.0508	1.07.2013	1.0508
SI	3.2400	3.2400		
SK	3.1800	3.1800	1.09.2013	1.2260
TR	1.4052	1.0887		
UK	1.8578	0.9970	1.04.2013	0.9970
Mesatare 'Pure' LRIC 2013			Eurocent	1.0550
			Lek	1.48

Shënime: 1. Tarifatat në eurocent në minutë dhe pa TVSH 2. Kursi i Këmbimit i përdorur 1 Euro=140 Lek

	Aplikuar ne 2013
	Planifikuar/propozuar 2014-2015: Sipas Cullen International_Dhjetor 2013/Shkurt 2014

Burimi: BEREC, Cullen International, AKEP

AKEP ka përditësuar informacionin e marrë për aplikimin e LRIC të pastër në tabelën e mësipërme. Përditësimi është bërë me informacionin e publikuar nga Cullen International në Dhjetor 2013 dhe Shkurt 2014. Nga ky përditësim i reflektuar në tabelën e mësipërme rezulton se:

- Listës së vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër i janë shtuar Sllovakia (SK) dhe Austria (AT) që kanë aplikuar tarifa sipas LRIC të pastër në Shtator dhe Nëntor 2011;
- Irlanda është shënuar me të verdhë, pasi aplikimi sipas LRIC të pastër është pezulluar dhe çështja është në apel.

Pra në vitin 2013 rezulton se 13 vende kanë aplikuar tarifat e terminimit celular bazuar në LRIC të pastër, dhe vlera mesatare është 1.055 eurocent/minutë apo 1.48 Lek/minutë. Megjithë ndryshimet e mësipërme nga këshillimi publik (12 vende përfshirë edhe Irlanda), tarifa mestare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013 ka një ndryshim shumë të vogël në eurocent por jo në vlerën e shprehur në Lek.

Përveç 13 vendeve që kanë aplikuar deri në fund të vitit 2013 LRIC të pastër, edhe 8 vende të tjera (përfshirë dy vende që kanë vendosur në 2013 por që janë pezulluar) kanë planifikuar apo përcaktuar glide path për aplikim deri në 2015 ose kanë publikuar për këshillim vlera të tarifave të terminimit sipas LRIC të pastër. Në këto vende që kanë vendosur apo planifikuar për aplikim të LRIC të pastër në vitet 2014-2015, përfshihen edhe dy vende të rajonit: Kroacia dhe Maqedonia.

Kroacia ka vendosur që më 1 Janar 2015 tarifa e terminimit sipas LRIC të pastër të jetë 0.83 eurocent/minutë, nga 2.55 eurocent/minutë në Korrik 2013.

Maqedonia ka vendosur që të arrijë vlerën 1.46 eurocent/minutë në Shtator 2014, nga 5.71 eurocent/minutë në Korrik 2013.

Turqia nuk është përfshirë në listën e vendeve që kanë aplikuar apo planifikuar për LRIC të pastër, pasi nuk ka informacion të tillë, por vlera prej 1.09 eurocent/minutë në Korrik 2013 është shumë e përafërt me mesataren e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër.

### 3.2.4.Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)

Tabela e mëposhtëme paraqet një përmbledhje të tarifave mesatare benchmark të diskutuara më sipër.

**Tabela 3: Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (benchmark)**

	Eurocent		Lek	
	Jan-13	Jul-13	Jan-13	Jul-13
<b>BEREC MES 34 (27 Anëtare të BE +7)</b>				
<b>E thjeshte</b>	2.58	2.22	3.61	3.11
<b>E ponderuar</b>	1.90	1.46	2.66	2.04
<b>EC MES.27 Anëtare të BE</b>	2.33	N/A	3.26	N/A
<b>Mesatare 'Pure' LRIC-2013</b>	1.055		1.48	

Burimi: BEREC, Cullen International, AKEP

Nga tabela mund të vihet re se:

- Tarifa mesatare e 27 vendeve anëtare të BE në 1 Janar 2013 është 2.33 eurocent/minutë, ndërsa në 34 vendet e referuara nga BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit) tarifa mesatare e ponderuar është 1.90 eurocent/minutë;
- Tarifa mesatare e ponderuar në 34 vendet e referuara nga BEREC më 1.07.2013 është 1.46 eurocent/minutë apo 2.04 lek/minutë.
- Tarifat mesatare në 27 vendet e BE dhe 34 vendet e referuara nga BEREC kanë pasur ulje të konsiderueshme në 2013 në raport me 2012, dhe kjo për shkak të rritjes së numrit të vendeve me LRIC të pastër.
- Tarifa mesatare e terminimit e 13 vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër deri në fund të vitit 2013 është 1.055 eurocent/minutë, apo 1.48 lek/minute.

# 4. Rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri

---

## 4.1 Alternativat për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare

Sic është theksuar në seksionin e Hyrjes, AKEP ka parashikuar rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare që në Analizën e tregut celular në Korrik 2012, ku AKEP ka dhënë qëndrimin e vet për përdorimin e BULRAIC (LRIC +) deri në 2013 dhe se në vitin 2014 metoda më e mirë është aplikimi i rregullimit të tarifave të terminimit duke iu referuar rekomandimit të KE të datës 7 Maj 2009.

Rekomandimi në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark) por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër.

Duke i'u referuar rekomandimit, AKEP me qëllim aplikimin e tij për tarifën e terminimit në rrjetet celulare, sic është bërë e njohur edhe në Analizë 2012, mund të ndërtojë një model të ri 'LRIC të pastër' ose të përdorë nivelin benchmark të vendeve që e kanë ndërtuar këto modele LRIC të pastër për përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare (sipas rekomandimit të KE).

Aplikimi i rekomandimit 2009 të KE, ka qënë objekt diskutimi në modelin BULRAIC të ndërtuar nga konsulenti ndërkombëtar ICC, dhe lexuesit mund t'i referohen dokumentave të publikuar nga AKEP për modelin BULRAIC. Në ndërtimin e modelit BULRIC në 2010 u gjykua që të aplikoheshin praktikat më të mira deri në atë kohë (BULRAIC normal apo LRIC+ sic referohet shpesh), pasi përvoja me LRIC të pastër ishte ende e kufizuar (vetëm 2 apo 3 shtete kishin filluar ndërtimin e tyre). Ndërtimi i një modeli të ri BULRAIC të pastër, do të kërkonte

përsëri konsulencë ndërkombëtare dhe shumë kohë për zbatimin e rekomandimit: zhvillimi i procedurave për përzgjedhje konsulenti dhe procedurat për ndërtimin dhe konsultimin e modelit. Pra marrja e rezultave do të ishte minimalisht nga fundi i vitit 2014 dhe zbatimi i tarifave sipas këtij modeli do të duhet të fillojë në vitin 2015.

Në vitin 2010 kishte vetëm pak vende (2-3) që kishin filluar implementimin e LRIC të pastër, ndërsa deri në Korrik 2013 rezulton se janë 12 vende anëtare ose candidate të BE që kanë vendosur tarifën e terminimit sipas modelit BULRAIC të pastër, dhe 7 vende të tjera që kanë vendosur/planifikuar aplikimin e tij deri në 2015. Nga analiza e vlerave të tarifave të terminimit e vendeve me LRIC të pastër, rezulton se tarifa është shumë më e ulët se me LRIC + dhe se diferencat midis vlerave të LRIC të pastër të aplikuar në vende të ndryshme janë të vogla (mestarja e 12 vendeve që kanë aplikuar deri në 2013 është e njëjtë me mesataren e 19 (12 +7) që kanë aplikuar apo marrë vendime për aplikim deri në 2015.

Për sa më sipër, AKEP gjykon se mënyra më efikase dhe më e mirë do të ishte rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit duke iu referuar nivelit mesatar të tarifave të terminimit në vendet që kanë aplikuar LRIC të pastër (vende anëtare të BE dhe të rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

## **4.2. Rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare**

Sic është theksuar në paragrafin e mëparshëm, AKEP gjykon që metoda më e mirë dhe efikase në kohë është rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare duke përdorur nivelin mesatar të këtyre tarifave në vendet që kanë aplikuar tashmë LRIC të pastër. Në përcaktimin e tarifave për secilin operator, AKEP gjykon se është e nevojshme që krahas nivelit mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE dhe rajonit që kanë aplikuar tashmë LRIC të pastër, të marrë në konsideratë edhe kushtet aktuale dhe pritshmëritë për zhvillimin e tregut celular në Shqipëri, me qëllim realizimin e objektivave rregullatore për rritjen e konkurrencës efektive në këtë treg dhe realizimin e objektivit final të maksimizimit të përfitimeve të përdoruesve fundorë nga shërbimet celulare në Shqipëri.

AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik propozoi që tarifat e terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë të jenë sipas niveleve dhe afateve kohore të dhëna në Tabelën 4 më poshtë. AKEP pasi morri në konsideratë komentet e palëve të interesuara gjykon të arsyeshme të kryejë disa ndryshime në tarifat e terminimit celular të propozuara në këshillim publik. Tarifat maksimale për t'u aplikuar nga operatorët celularë në Shqipëri do të jenë sipas vlerave dhe afateve kohore në tabelën e mëposhtme 4/1. Tabelat e tjera paraqesin asimetrinë e propozuar në këshillim public dhe asimetrinë e vendosur në këtë version final. Ndryshimet e kryera në këtë version final në krahasim me versionin në këshillim publik janë:

- Faza e parë e reduktimit fillon më 1.04.2014 dhe jo më 1.03.2014. Ky ndryshim është bërë për shkak të kohës së nxjerrjes së këtij versioni final të dokumentit dhe vendimeve përkatëse. Faza e dytë e reduktimit fillon më 1.04.2015 dhe jo më 1.01.2015;
- Tarifat e terminimit në rrjetet AMC dhe Vodafone në dy fazat e para janë vendosur 2.66 dhe 2.04 lek/minutë, të cilat janë të barabarta me vlerat e tarifave mesatare të ponderuara të terminimit të publikuar nga BEREC për Janar 2013 dhe Korrik 2013 (Tabela 3 në seksionin e mëparshëm).
- Tarifa e terminimit në rrjetin Albtelecom (EM) në fazën e parë reduktohet në 4.00 lek/minutë nga 4.57 lek minutë që ishte propozimi në këshillim publik, dhe në fazën e dytë reduktohet në 2.66 lek/minutë, e njëjtë me tarifën e terminimit në AMC/Vodafone në fazën e parë.

Këto ndryshime cojnë dhe në reduktim të asimetrisë nga faza e parë në të dytën, në ndryshim nga propozimi në këshillim publik ku kishte një rritje të asimetrisë në fazën e dytë për tarifat e EM dhe Plus në raport me tarifat e Vodafone/AMC.

Tabela 4: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit celular në Shqipëri 2014-2016

**Këshillimi Publik:**

	1.09.2013	1.03.2014	1.01.2015	1.01.2016-
Vodafone/AMC	4.57	3.03	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	4.57	4.57	3.03	1.48
Plus	8.85	6.52	4.00	1.48

Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH

**Versioni Final:**

	1.09.2013	1.04.2014	1.04.2015	1.01.2016-
Vodafone/AMC	4.57	2.66	2.04	1.48
Albtelecom (EM)	4.57	4.00	2.66	1.48
Plus	8.85	6.52	4.00	1.48

Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH

Tabela 5: Asimetria në përqindje e tarifave të terminimit

**Këshillimi Publik:**

	1.09.2013	1.03.2014	1.01.2015	1.01.2016
Albtelecom (EM)/Vodafone-AMC	0%	51%	104%	0%
PLUS/Vodafone-AMC	94%	116%	170%	0%
PLUS/ Albtelecom (EM)	94%	43%	32%	0%

**Versioni Final:**

	1.09.2013	1.04.2014	1.04.2015	1.01.2016
Albtelecom (EM)/Vodafone-AMC	0%	51%	30%	0%
PLUS/Vodafone-AMC	94%	145%	96%	0%
PLUS/ Albtelecom (EM)	94%	63%	51%	0%

Tabela 6: Asimetria (diferenca) në vlerë absolute e tarifave të terminimit (lek/minutë)

**Këshillimi Publik:**

	1.09.2013	1.03.2014	1.01.2015	1.01.2016
Albtelecom (EM)/Vodafone-AMC	0.00	1.55	1.55	0.00
PLUS/Vodafone-AMC	4.28	3.50	2.52	0.00
PLUS/ Albtelecom (EM)	4.28	1.95	0.98	0.00

**Versioni Final:**

	1.09.2013	1.04.2014	1.04.2015	1.01.2016
Albtelecom (EM)/Vodafone-AMC	0.00	1.34	0.61	0.00
PLUS/Vodafone-AMC	4.28	3.86	1.96	0.00
PLUS/ Albtelecom (EM)	4.28	2.52	1.34	0.00



Sic mund të vihet re nga vlerat e tabelave të mësipërme, AKEP ka vendosur që:

- Tarifat e terminimit në rrjetet e të katër operatorëve të reduktohen gradualisht, duke aplikuar 2 faza të ndërmjetme 1.04.2014-31.03.2015 dhe 1.04.2015-31.12.2015, dhe një asimetri midis dy operatorëve të mëdhenj dhe dy operatorëve më të vegjel (hyrës të rinj) deri më 31.12.2015.
- Tarifat e terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë më 1.01.2016 të jenë në nivelin 1.48 lek/minutë, të njëjtë me mesataren në vendet e BE dhe rajonit që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013 (1.06 eurocent/minutë);
- Tarifat e terminimit në rrjetet e Vodafone dhe AMC më 1.04.2014 të reduktohen në 2.66 lek/minutë, dhe 2.04 lek/minutë më 1.04.2015, vlera të cilat janë të barabarta me nivelet e tarifës mesatare të ponderuar në vendet e BEREC në Janar 2013 dhe Korrik 2013;
- Tarifa e terminimit në Albtelecom (EM) në fazat e ndërmjetme të jetë:
  - o 4.00 lek/minutë më 1.04.2014, e njëjtë sa tarifa e terminimit në Plus në fazën e dytë;
  - o 2.66 lek/minutë më 1.04.2015, e barabartë me tarifën e terminimit në AMC/Vodafone në fazën e parë;
- Tarifa e terminimit në Plus Communications në fazat e ndërmjetme të jetë:
  - o 6.52 lek/minutë më 1.04.2014, e njëjtë me tarifën për t'u aplikuar nga ky operator më 1.09.2014, sipas Vendimeve të AKEP më 4.07.2012;
  - o 4.00 lek/minutë më 1.04.2015, e barabartë me mesataren e tarifave për këtë operator më 1.04.2014 dhe 1.01.2016.


Në përcaktimin e tarifave të propozuara më sipër, AKEP ka marrë në konsideratë ecurinë e tregut celular dhe pritshmëritë për të ardhmen, me qëllim garantimin e kushteve të barabarta të konkurrencës midis operatorëve në treg. Asimetria e përcaktuar në këtë dokumnet është e përkohshme dhe gjykohet e arsyeshme në kushtet aktuale të tregut në Shqipëri, duke marrë parasysh faktin që pavarësisht re-prezantimit të asimetrisë për EM dhe rritjes së asimetrisë së Plus në fazën e parë (Tabela 5), asimetria vjen në zvogëlim deri në konvergim më 1.01.2016 në nivelin 1.48 lek/minutë për të katër operatorët celularë. Gjithashtu asimetria në vlerë absolute (diferenca midis tarifave të operatorëve të ndryshëm) vjen në rënie (Tabela 6), deri në konvergjencë më 1.01.2016. AKEP në përcaktimin e tarifave të propozuara, përveç nivelit

mesatar të tarifave në BE dhe rajon dhe aplikimin e LRIC të pastër, ka marrë në konsideratë gjithashtu edhe rekomandimet e ndryshme të BEREC (ERG) për nivelin e asimetrisë, në lidhje me faktorët dhe relevancën e secilit faktor që ndikon në përcaktimin e asimetrisë, në kushtet e tregut celular në Shqipëri.

## 5. Efektet e pritshme

Figura e mëposhtme paraqet krahasimin e tarifave të terminimit celular në Shqipëri (të aplikuara dhe të përcaktuara në këtë dokument) dhe tarifave në vendet e BE dhe rajonit (2012-2016).

Figura 3: Tarifat mesatare të terminimit në vendet e BE dhe rajonit dhe Shqipëri (2012-2016)



Burimi: AKEP, BEREC, Cullen International,

Sic mund të vihet re, tarifat e terminimit celular në Shqipëri kanë qënë afër nivelit mesatar të BE në 2012, dhe më pas për shkak të reduktimeve të mëdha në vendet e BE dhe rajonit, në 2013 ato qëndrojnë shumë më lart se niveli mesatar në vendet e e cituara. Reduktimet e përcaktuara në këtë dokument cojnë:

- Në Prill 2014 dhe Prill 2015 tarifat e terminimit të Vodafone dhe AMC barazohen me tarifat mesatare në 34 vendet e raportuara nga BEREC në Janar dhe Korrik 2013;

- Në Janar 2016 tarifat e të katër operatorëve celularë barazohen me tarifën mesatare në vendet e BE dhe rajonit (të referuara nga BEREC) që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013.

**Tabela 7: Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në Shqipëri (1.04.2014-1.01.2016)**

	<b>1.04.2014/aktuale</b>	<b>1.04.2015/aktuale</b>	<b>1.01.2016/aktuale</b>
<b>Vodafone/AMC</b>	-42%	-55%	-68%
<b>Albtelecom (EM)</b>	-12%	-42%	-68%
<b>Plus</b>	-26%	-55%	-83%

Reduktimi në fazën e parë më 1.04.2014 varion nga 12 deri në 42%. Më 1 Prill 2015, reduktimet janë 42-55% krahasuar me nivelin aktual dhe më 1.01.2016, reduktimi është 68-83% në raport me nivelet përkatëse aktuale të tarifave të terminimit.

Tregu celular në Shqipëri ka pasur zhvillime pozitive në vitet e fundit në drejtim të rritjes së konkurrencës dhe përfitimeve të përdoruesve, në terma të tarifave më të ulëta dhe rritje të ndjeshme të përdorimit mesatar. Megjithatë, nga monitorimi i tregut dhe ankesat e operatorëve, AKEP ka venë re se konkurrenca dhe përfitimet e përdoruesve kanë qenë të fokusuara në drejtim të thirrjeve brenda rrjeteve (on-net), tarifat e të cilave në shumë raste kanë skonto të mëdha për thirrjet brenda grupeve të mbyllura (closed users groups). Kjo praktikë vihet re se aplikohet nga të katër operatorët dhe në programet tarifore me parapagim dhe me kontratë. Efektet e këtyre politikave tarifore kanë cuar në rritje të madhe të proporcionit që zënë thirrjet brenda rrjetit në totalin e thirrjeve dalëse celulare (mesatarisht 95%).

Nivelet e propozuara të tarifave të terminimit në seksionin e mëparshëm, janë përcaktuar me objektivin e rritjes së konkurrencës në tregun celular duke pasur parasysh rritjen e aftësisë konkurruese të operatorëve më të vegjël dhe reduktimin/eliminimin e stimujve për diferenca të pajustificuara midis tarifave on-net dhe off-net. Tarifat e propozuara i shërbejnë në disa drejtime rritjes së aftësisë konkurruese të operatorëve më të vegjël dhe njëkohësisht objektivit final të maksimizimit të përfitimeve të përdoruesve fundore:

- Reduktimi i ndjeshëm i tarifave të terminimit në rrjetet e dy operatorëve më të mëdhenj con në reduktimin e shpenzimeve të operatorëve më të vegjël për thirrje off-net;<sup>7</sup>
- Reduktimi i tarifave të terminimit edhe për operatorët më të vegjël dhe diferencat e uluara në vlerë absolute midis operatorëve më të vegjël dhe atyre më të mëdhenj, eliminon stimuj të mundshëm për diferencim në tarifatat off-net me pakicë të thirrjeve drejt operatorëve më të vegjël;
- Reduktimi i ndjeshëm i tarifave të terminimit për të katër operatorët celularë con në reduktimin e ndjeshëm të kostove të thirrjeve off-net dhe në stimulim të ofrimit të thirrjeve off-net dhe paketa tarifore me minuta kombëtare (drejt të gjitha rrjeve celulare), me tarifa më të lira.
- Orientimi në koston LRIC të pastër gjykohet si një nga masat me efekt më të madh në rritjen e konkurrencës në treg.

Reduktimet e propozuara të tarifave të terminimit gjykohet të se do të japin një impuls pozitiv në rritjen e mëtejshme të konkurrencës në tregun celular me pakicë në Shqipëri dhe eliminimin/reduktimin e stimujve për tarifa shumë të ulëta on-net, dhe rritjen e stimujve për paketa tarifore me minuta kombëtare (drejt të gjitha rrjeve celulare). Politika të tilla tarifore pritet të kenë efekt pozitiv në treg dhe zgjedhja e përdoruesve e këtyre paketave do të zvogëlojë stimujt për paketat me tarifa shumë të ulëta brenda grupeve. Kjo mund të çojë edhe në reduktim të kartave SIM aktive në treg, pasi një pjesë e madhe e përdoruesve celularë kanë më shumë se një kartë SIM për të shfrytëzuar oferta me tarifa shumë të ulëta on-net (brenda grupeve). Megjithatë rënia e përdorimit të kartave SIM aktive nuk do të thotë, reduktim i përfitimeve të përdoruesve, pasi një gjë e tillë ndodh edhe me portabilitetin e numrit. Rregullimet e propozuara pritet të kenë efekt në rritje të trafikut off-net duke zvogëluar proporcionin shumë të madh aktual të trafikut on-net.

---

<sup>7</sup> Pagesat neto janë një faktor që merret në konsideratë në përcaktimin e asimetrisë, por ai nuk është faktor përcaktues kryesor, pasi operatori origjinues presupozohet që merr të ardhura nga retail dhe paguan operatorin tjetër për terminim si wholesale. Një operator mund të ketë pagesa neto për të kryer (kjo mund të ndodh në simetri dhe në asimetri tarifash), por nuk do të thotë që të ketë humbje nga thirrjet off-net.

## **Rekomandimet e AK dhe tregu me pakicë**

Autoriteti i Konkurrencës (AK) me datë 25.01.2014 ka dërguar në AKEP Vendimin nr.303, datë 16.01.2014, “*Per Mbylljen e Hetimit te Thelluar ne tregun e telefonise celulare me pakice ndaj ndermarrjes Vodafone Albania sh.a dhe rekomandime per AKEP*”. Vendimi nr.303, datë 16.01.2014 është marrë në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar të nisur nga AK me Vendimin nr. 275, datë 25,03.2013, "Per hapjen e procedures se hetimit te thelluar ndaj ndermarrjes Vodafone Albania SHA ne tregun e telefonise celulare me pakice". Nëpërmjet vendimit AK ka përcaktuar se Vodafone Albania ka pasur pozitë dominuese në periudhën 2011-2012 por nuk ka abuzuar me këtë pozitë. AK ka vendosur mbylljen e hetimit të thelluar duke dhënë disa rekomandime për AKEP.

Publikimi i versionit final të dokumentit ‘*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*’ dhe vendimet përkatëse për tarifën e terminimit në rrjetet celulare përbën një rregullim të ndërmarrë nga AKEP pavarësisht nga përfundimet e AK dhe i paralajmëruar nga AKEP që në Analizë tregu 2012, përbën në të njëjtën kohë plotësim të rekomandimit të AK në pikën II.1/a të Vendimit nr.303, datë 16.01.2014, për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare.

Në lidhje me argumentat dhe propozimet për ndërhyrje paralele në nivel me shumicë dhe me pakicë, përfshirë formulat e ndryshme të propozuara nga operatorë të ndryshëm në komentet dhëna në këshillim publik, AKEP gjykon se:

- rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare për orientim në kostot LRIC të pastër, është një kusht i nevojshëm që duhet ndërmarrë, sic është parashikuar dhe planifikuar nga AKEP që në Analizë tregu celular 2012, dhe është në vijim të statusit me FNT të secilit operator celular për terminimin e thirrjeve në rrjetin e vet.
- Cdo lloj mase nga AKEP për rregullim të tarifave celulare në nivel me pakicë, për një operator sipas rekomandimit të AK, apo për më shumë operatorë, do të jetë objekt i një analize më të detajuar nga AKEP, sic është analiza e tregut celular, pasi bazuar në ligjin 9918 dhe direktivat/rekomandimet e KE/BEREC rregullimi i tarifave në nivel me pakicë është masa e fundit rregullatore që vendoset për FNT në treg me pakicë dhe kur gjykohet se masat e tjera rregullatore në nivel me shumicë nuk pritët të kenë efektin e duhur në konkurrencën afat-gjatë midis operatorëve në treg.

AKEP gjykon që të fillojë implementimin e tarifave të terminimit sipas niveleve dhe afateve të dhëna në këtë dokument (Seksioni 4), dhe në Analizën e tregut celular, që është parashikuar të kryhet në 2014, të rishikojë efektet e masave të marra në tregun me pakicë dhe politikat tarifore të operatorëve si dhe nëse ka nevojë për masa të tjera të mundshme rregulluese. Analiza e tregut celular do të trajtojë në mënyrë më të detajuar tregun me pakicë dhe problematikën e tarifave të ulëta brenda grupeve të mbyllura/on-net. Në këtë proces AKEP do të konsiderojë dhe masat e mundshme të propozuara nga Altelecom (EM) dhe Plus në komentet e dhëna në këshillim publik të këtij dokumenti.

## Aneks 1: Lista e Shkurtimeve të Shteteve

---

<b>Simboli</b>	<b>Shteti</b>
<b>AT</b>	Austri
<b>BE</b>	Belgjik
<b>BG</b>	Bullgari
<b>CH</b>	Zvicër
<b>CY</b>	Qipro
<b>CZ</b>	Çeki
<b>DK</b>	Danimarkë
<b>DE</b>	Gjermani
<b>EE</b>	Estoni
<b>EL</b>	Greqi
<b>ES</b>	Spanje
<b>FI</b>	Finlandë
<b>FR</b>	Francë
<b>HR</b>	Kroaci
<b>HU</b>	Hungari
<b>IE</b>	Irlandë
<b>IS</b>	Islandë
<b>IT</b>	Itali
<b>LT</b>	Lituani
<b>LV</b>	Letoni
<b>LU</b>	Luksemburg
<b>FYROM</b>	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
<b>NL</b>	Hollandë
<b>NO</b>	Norvegji
<b>PL</b>	Poloni
<b>PT</b>	Portugali
<b>RO</b>	Rumani
<b>RS</b>	Serbi
<b>SE</b>	Suedi
<b>SI</b>	Slloveni
<b>SK</b>	Sllovaki
<b>TR</b>	Turqi
<b>UK</b>	Mbreteria e Bashkua(Angli)